

VENDIM
Nr.140, datë 13.2.2008

**PËR MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME,
TË SEKUESTRUARA, NË KUADËR TË MASAVE KUNDËR FINANCIMIT TË
TERRORIZMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim rregullon çështjet, që lindin në çastin e fillimit të procedurave për vendosjen e sekuestros mbi pasuritë e paluajtshme, në mbështetje të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

2. Administrimi i pasurive të paluajtshme, të sekuestruara, që kanë për pronarë personat e shpallur si financues të terrorizmit, bëhet nga Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, më poshtë AAPSK, menjëherë pas vendosjes së sekuestros.

3. Inventari i pasurive të paluajtshme dhe procesverbali i marrjes në dorëzim të tyre kryhen nga një komision, i ngritur me urdhër të Ministrit të Financave, i cili ka në përbërje një administrator, të caktuar nga AAPSK-ja, një përfaqësues të autoritetit, që ka kryer sekuestrimin, dhe një përfaqësues të Ministrisë së Financave.

II. PASURITË E PALUAJTSHME

1. Pasuritë e paluajtshme të sekuestruara, u jepen në përdorim:

a) institucioneve shtetërore buxhetore, me urdhër të Ministrit të Financave, pasi të jetë lidhur një kontratë huapërdorjeje, e cila nënshkruhet nga huamarrësi dhe kryeadministratori i AAPSK-së;

b) subjekteve private, pasi të jetë lidhur një kontratë qiraje, e cila nënshkruhet nga qiramarrësi dhe kryeadministratori i AAPSK-së.

2. Vlera e kontratës së qirasë përcaktohet sipas ofertës të tregut, ndërsa mënyra dhe procedurat për dhënien me qira të pasurive të paluajtshme, të sekuestruara, përcaktohen nga Ministri i Financave.

3. Institucionet shtetërore, buxhetore, dhe subjektet private përballojnë çdo shpenzim, për pasurinë e marrë në përdorim, në formën e huapërdorjes, ose me qira.

4. Të ardhurat e krijuara nga administrimi i pasurisë së sekuestruar derdhen në llogari likuiduese, të hapura me autorizim të Ministrit të Financave, në njërin nga bankat e nivelit të dytë, në emër të AAPSK-së. Këto llogari funksionojnë dhe administrohen sipas rregullave të përcaktuara nga Ministri i Financave, në përputhje me ligjin nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

5. Shpenzimet për administrimin e pasurisë përballohen nga llogaritë përkatëse, të përmendura në pikën 4 të këtij kreu.

6. Kur të ardhurat e krijuara nga administrimi i pasurive të paluajtshme, të sekuestruara, nuk mjaftojnë për përballimin e shpenzimeve të kryera për administrimin e tyre, diferenca mbulohet nga Buxheti i Shtetit.

7. Për pasuritë e paluajtshme, që janë në bashkëpronësi, dhe që, për shkaqe objektive, administrimi i tyre është i pamundur, administratori kërkon pjesëtimin e sendit në rrugë gjyqësore.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Vendimi nr.491, datë 30.6.2005 i Këshillit të Ministrave “Për disa çështje për sekuestrimin e pasurive të paluajtshme, në kuadër të masave kundër financimit të terrorizmit” shfuqizohet.

Kontratat e lidhura në zbatim të vendimit nr.491, datë 30.6.2005 të Këshillit të Ministrave, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, ruajnë fuqinë dhe efektet juridike.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha